



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.364/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Violeta Husaj Rugova - kryesuese, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi- anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Refki Ramadani, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Gjilanit, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Gjilan, të paraqitura kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në pranimin e zarfeve nga vendvotimi jashtë Kosove, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 31.10.2025, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZL.Anr.364/2025, e datës 29.10.2025, e parashtruar nga Refki Ramadani, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Gjilanit, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, të paraqitura kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në pranimin e zarfeve nga vendvotimi jashtë Kosove, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Më datë 29.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën ZL.Anr.364/2025, të dorëzuar përmes postës me datë 24.10.20235, nga Refki Ramadani, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Gjilanit, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në të cilën theksohet se paraqes këtë ankesë zyrtare lidhur me mos përfshirjen e disa votave të ardhura me postë nga diaspora, të cilat janë dërguar në kohë dhe në përputhje me udhëzimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Sipas informacioneve dhe dëshmive të bashkëngjitura që kam në dispozicion, votat e mëposhtme janë dërguar në afatin e përcaktuar nga KQZ dhe përmes kanaleve të sugjeruara zyrtarisht, por deri më sot nuk janë marrë parasysh apo nuk janë numëruar nga organet përkatëse. Nga Kanada tre votues kanë dërguar fletëvotimet e tyre me postë (përmes UPS dhe/ose postave të tjera të shpejta) në Konsullatën e Republikës së Kosovës në New York, me qëllim që të shmanget vonesa për shkak të protestës së shërbimeve postare në Kanada, dhe në përputhje të plotë me njoftimet zyrtare të KQZ-së për mënyrën dhe afatin e dorëzimit të fletëvotimeve nga jashtë. Votuesit janë [REDACTED]

[REDACTED] Ndërsa nga SHBA dy votues kanë dërguar fletëvotimet e tyre drejtpërdrejt në Konsullatën e Kosovës në New York në përputhje me afatin dhe udhëzimet e

KQZ-së. Megjithatë, këto zarfe nuk kanë arritur në Kosovë, për arsye të panjohura, ndonëse janë dërguar brenda afatit të përcaktuar. Votuesit janë: [REDAKTUAR] Andaj, bazuar në të drejtën e garantuar për votë, kërkoj që PZAP të ndërmarrë veprimet e mëposhtme: të verifikojë pranimin e zarfave në Konsullatën e Kosovës në New York dhe datën e dorëzimit të tyre; të kërkojë nga KQZ dhe Posta e Kosovës sqarim lidhur me pranimin, dërgimin dhe trajtimin e këtyre zarfeve, të bëjë përpjekje për identifikimin dhe numërimin e këtyre votave, nëse ato kanë arritur në kohë ashtu siç dëshmohet nga dokumentacioni i dorëzimit dhe të sigurojë përfshirjen e këtyre votave në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, nëse ato janë të vlefshme. Në bashkëngjitje të kësaj ankese dorëzoj: kopje të dokumenteve të dërgimit të zarfeve për secilin nga shtetet e përmendura më sipër, përfshirë: numrat e përcjelljes (tracking numbers), datat e dorëzimit sipas postës përkatëse, dëshmitë e pranimin nga Konsullata e Kosovës në New York (kur janë të disponueshme), deklaratat dhe dokumentet përcjellëse të dërguara nga votuesit. Këto dokumente provojnë se zarfet janë dorëzuar brenda afatit të përcaktuar nga KQZ, në mënyrën e rekomanduar për çdo shtet. Mos numërimi i këtyre votave cenon të drejtën e votuesve për përfaqësim dhe ndikon negativisht në integritetin e procesit zgjedhor.

Në përgjigjen në ankesë KQZ-ja, me datë 30.10.2025, thekson se: me datën 03.09.2025, KQZ ka miratuar Procedurën Standarde të Veprimit për Votimin Jashtë Kosovës dhe Vlerësimin e Pakove me Fletëvotime. Në faqen 14 të kësaj procedure shpjegohet mënyra e vlerësimit të pakove me fletëvotime, ndërsa pas përfundimit të procesit të verifikimit të zarfeve me fletëvotime, DSHV dorëzon në QNR listën e votuesve të cilët kanë votuar përmes postës dhe zarfet me fletëvotime të ndara në kuti sipas komunave të votuesve.

Duke u bazuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Ligji nr.08/L-228, neni 96, pika 3 “3. Votimi jashtë Kosovës organizohet nga KQZ-ja dhe votuesit mund të votojnë duke u përcaktuar individualisht për mënyrën e votimit, në momentin e regjistrimit përmes platformës së KQZ-së: 3.1 fizikisht, në përfaqësi diplomatike të Republikës së Kosovës apo hapësira të tyre, të cilat shndërrohen në qendra të votimit sipas kriterëve të përcaktuara nga KQZ-ja për adaptimin në qendra të votimit. Kjo mënyrë votimi nuk aplikohet në zgjedhje lokale; 3.2 duke dërguar fletëvotimet përmes kutisë postare të KQZ-së, në postën e Kosovës; 3.3 duke dërguar fletëvotimet përmes postës në një nga kutitë postare të hapura nga KQZ-ja përmes dhe me lehtësimin e përfaqësive diplomatike, jashtë Kosovës”.

Rregulla Zgjedhore 04/2025 - Regjistrimi dhe Votimi jashtë Kosovës neni 8 përcakton se KQZ, me ndihmën e përfaqësive diplomatike, hap kuti postare jashtë Kosovës në postat e shteteve ku ka shtetas të Republikës së Kosovës. Kutitë postare jashtë Kosovës shërbejnë për të dërguar fletëvotimet shtetasit që regjistrohen suksesshëm për votim jashtë Kosovës. Gjithashtu, në Procedurën Standarde të Veprimit për Votimin Jashtë Kosovës dhe Vlerësimin e Pakove me Fletëvotime është përcaktuar në pikat:

3.2.5 Votuesit e regjistruar me sukses për votim jashtë Kosovës mund të dërgojnë paket me fletëvotimet në njërin nga kutitë postare të hapura nga KQZ.

3.2.6 Vetëm zarfet që pranohen në kutitë postare të KQZ-së procedohen për vlerësim, 3.2.7 Në rastet kur shërbimi postar dërgon zarfet në përfaqësi diplomatike dhe në zarf është shënuar kutia postare e KQZ-së, zyrtari i Përfaqësive Diplommatike nuk e pranon zarfin dhe kërkon nga shërbimi postar që zarfet të dërgohen në kutinë postare. Ndërsa në rastet kur nuk është e shënuar

adresa e kutisë postare, zyrtari i Përfaqësisë Diplomatike kërkon nga shërbimi postar që zarfi ti kthehet votuesit dhe njofton DSHV-në për raste të tilla në mënyrë që të njoftohet votuesi. Në rastin e shtetit të Kanadasë për shkak të protestës së postës Divizioni i Shërbimit Votues ka njoftuar të gjithë votuesit e regjistruar suksesshëm nga shteti i Kanadasë të dërgojnë zarfet në kutinë postare të KQZ të hapur në New York. Më poshtë njoftimi së bashku me udhëzimet i cili është dërguar te të gjithë votuesit: *"I/ e nderuar; Ju njoftojmë se, si pasojë e grevës së shpallur në shërbimin postar të Kanadasë, dërgimi i zarfeve me fletëvotime në kutinë postare të KQZ në Kanada do të jetë i pamundur. Në këtë rast, për të siguruar që zarfi juaj të arrijë në kohë dhe të jetë i vlefshëm, ju rekomandojmë që ta dërgoni atë përmes një shërbimi postar privat (p.sh. DHL, FedEx, UPS etj.) në kutinë postare të KQZ të hapur në SHBA, Adresa e kutisë postare në SHBA: Consulate General of Kosovo in New York – KQZ; 450 Lexington Ave Unit 4485 New York, NY 10163. Megjithatë, ju keni mundësi të zgjedhni njërën prej kutive postare të KQZ për të dërguar zarfin, përderisa zarfi të dërgohet nga Kanada (bashkangjitur gjeni listën e kutive postare KQZ). Ju lutemi që me kujdes të largoni etiketën e vendosur nga KQZ në zarfin ngjyrë kafe (etiketa e poshtme, në anën e djathtë), ku është shënuar adresa e kutisë postare në Kanada. Pasi ta largoni etiketën, në të njëjtin vend, shkruani me laps kimik adresën e kutisë postare të KQZ-së që keni zgjedhur për ta dërguar zarfin. Ju lutemi mos e dërgoni zarfin në Ambasadën e Kosovës në Kanada, pasi zarfet e pranuar konsiderohen të pavlefshme dhe do t'ju kthehen."*

Divizioni i Shërbimit Votues ka udhëzuar stafin e misionëve diplomatike që të gjitha zarfet e pranuar në Konsullata të kthehen në adresë të votuesit pasi të njëjtat nuk janë pranuar sipas kritereve të përcaktuara.

KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe votat me postë, gjenden në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet e drejtësisë.

PZAP ka kërkuar nga KQZ-së që të verifikoj nëse zarfet e cekura në ankesë, kanë arritur në Kosovë dhe nëse të njëjtat janë numëruar. Me dt.30.10.2025 KQZ nëpërmjet E-mailit është përgjigjur duke theksuar se janë verifikuar zarfet e cekura në ankesë, dhe të njëjtat rezultojnë se:

██████████ – Zarfi me fletëvotim është aprovuar dhe është dërguar për numërim në QNR.

██████████ dani – Zarfi me fletëvotim është aprovuar dhe është dërguar për numërim në QNR, ██████████ – KQZ nuk ka pranuar zarf me fletëvotim nga asnjëra kuti postare e KQZ,

██████████ – Zarfi me fletëvotim është aprovuar dhe është dërguar për numërim në QNR. ██████████ zarfi me fletëvotim është aprovuar dhe është dërguar për numërim në QNR.

-Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës dhe përgjigjeve në ankesë konstaton se:

- **Ankesa është e pabazuar.**

Paneli i ka vlerësuar pretendimet ankimore të parashtruara nga Refki Ramadani, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Gjilanit, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), të paraqitur kundër KQZ-së, me pretendimet se sipas informacioneve dhe dëshmive të bashkangjitura që ka në dispozicion, votat nga Kanada të

votuesv [redacted] dhe nga SHBA, të votuesve [redacted] janë dërguar në afatin e përcaktuar nga KQZ dhe përmes kanaleve të sugjeruara zyrtarisht por të njëjtat nuk janë marrë parasysh apo nuk janë numëruar nga organet kompetente. Mirëpo Paneli vlerësoi se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga pretendimet e theksuara në ankesë se ka mungesë të votave të publikuara me numrin real të votave të konfirmuara nga votuesit nga jashtë, paneli nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pala ankuese pretendon me ankesën e tij. Ndërsa nga përgjigja e KQZ rezulton se votue [redacted] Zarfi me fletëvotim është aprovuar dhe është dërguar për numërim ne QNR, votuesi [redacted] – Zarfi me fletëvotim është aprovuar dhe është dërguar për numërim ne QNR, votuesi [redacted] – Zarfi me fletëvotim është aprovuar dhe është dërguar për numërim ne QNR, votuesi [redacted] – Zarfi me fletëvotim është aprovuar dhe është dërguar për numërim ne QNR, do të thotë se nuk qëndrojnë pretendimet se votat e tyre nuk janë marrë parasysh apo nuk janë numëruar nga organet përkatëse. Ndërsa lidhur me votuesin Votuesen [redacted] – KQZ nuk ka pranuar zarf me fletëvotim nga asnjëra kuti postare e KQZ dhe këtë parashtuesi i ankesës duhet ta adresoj pranë Konsullatës së Republikës së Kosovës në New York ose pranë shërbimeve postare.

Pra, sa i përket pretendimeve të palës ankuese që kanë të bëjnë me votimin jashtë vendit, konkretisht me pretendimin se mungojnë 3 vota nga Kanada dhe dy vota nga SHBA, sipas vlerësimit të panelit e bazuar në nenin 4 paragraf 1.3 të LZP, nuk janë të bazuara mbi arsyet e cekura më lartë. Parashtuesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur veprime që janë shkelur dispozitat ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtuesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se “*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar në nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.364/2025 më datën 31.10.2025

Kryesuese e Panelit,
Violeta Husaj Rugova



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118, paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.